



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 02-327  
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Qendra për Aftësim Profesional “American Beauty School” me dy lokacione, në Ferizaj me adresë Rruga 12 qershori dhe në Gjilan Rruga Gjon Serreqi, për periudhën 27.09.2017 deri 27.09.2020 me kualifikimin:

### **1.1. Manikyrist/Manikyriste, Niveli III sipas KKK me 10 kredi të AAP.**

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:

#### **Manikyrist/Manikyriste**

- 2.1. Hartimi i politikave dhe i procedurave të sistemit për sigurimin e cilësisë, përfshirë dokumentacionit dhe mekanizmat përkatës si dhe proceset e punës.
- 2.2. Trajnime të vazhdueshme të trajnerëve për të mbajtur hapin me zhvillimet më të reja në fushën e manikyrisë.
- 2.3. Në qendrën e Gjilanit të punësohet edhe një trajner me përvojë më të gjatë, kurse trajneria e tashme të vazhdojë punën si asistente për një afat të caktuar kohor deri në përsosjen e mënyrës së mësimdhënies dhe edukimit shtesë.
- 2.4. Në dy qendrat rekomandohen, gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme për dezinfektim dhe sterilizim të pajisjeve dhe mjeteve të punës, nga një lavaman dhe ujë të ngrohtë në afërsi të kabinetit praktik.
- 2.5. Të bëhet renditja adekuate e moduleve obligative dhe atyre zgjedhore në përputhshmëri me standardin e aprovuar nga MASHT-i.

- 2.6. Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve të organizohet në praninë e vlerësuesve të jashtëm.
- 2.7. Në sallat e praktikës të ketë klimatizim që i përshtatet hapësirës punuese. Në afërsi ose në sallën praktike të jenë të vendosura edhe orenditë në të cilat do të mund të vendosen materialet ditore për punë si: peshqirë të pastër, limat, bllokat, mjetet dezinfektuese, llakat, enët etj.
- 2.8. Sugjerohen 2 ndërrime te grupeve punuese në ditë dhe 10 kandidatë maksimumi në grup gjatë orëve praktike, me përjashtim të orëve teorike dhe vlerësimit teorik ku numri i kandidatëve në grup mund të jetë më i madh se 10, si rezultat i hapësirës së sallës teorike.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën 30.12.2017 sipas raportit të jashtëm vlerësues për kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

### **A r s y e t i m**

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

#### Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
- American Beauty School;
  - AKK.



Bedri Xhafa  
Kryetari i KD së AKK-së